



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E GJAKOVËS
OPSTINA GJAKOVICA MUNICIPALITY OF GJAKOVA
Republika e Kosovës - Opština Djakovica
Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative
Uprava za Opšte, Administrativne Poslove

Nr./Br. 413/01-21935
Data 26.07.2018
Gjakovë - Djakovica - Gjakova

Marrëveshje partneriteti - Marrëveshje
Qeveritare

Në mes të

Save the Children International në Kosovë

Nr i regjistrimit 5300542-0, nr. fiskal 600765343 dhe Statusit të përfitimit publik 6001229-6

Rr: Gazmend Zajmi nr:1,10000 Prishtinë, Kosovë
(në tekstin e mëtejme "SCI")

dhe

Drejtorisë Komunale të Arsimit në Gjakovë.
Rr. Nëna Tereze pn. 50000 Gjakovë, Kosovë
(në tekstin e mëtejme "DKA")

dhe

~~Drejtorisë Komunale të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Gjakovë.~~

Rr. Nëna Tereze pn. 50000 Gjakovë, Kosovë
(në tekstin e mëtejme "DKSHMS")

Numri identifikues i marrëveshjes: 11131

Kjo marrëveshje bëhet me qëllim të bashkëpunimit midis SCI-së, DKA dhe DKSHMS për realizimin e aktiviteteve specifike në kuadër të projektit *Përmirësimi i qasjes dhe cilësisë në Kujdesin dhe Zhvillimin gjatë Fëmijërisë së Hershme në Kosovë - (SCI SoF): 38000507 dhe numër të partnerit: 41300057* ("Projekti").

Fondet që do të vihen në dispozicion nga ana e SCI-së për Projektin sigurohen nga Save the Children Italia në kuadër të një marrëveshjes ("Marrëveshja Kryesore") me Fondacionin Ferrari ("Donatori").

Detajet rreth aktiviteteve të Projektit janë paraqitur në Dokumentet e Projektit të bashkëlidhura me këtë marrëveshje si Shtojca A dhe B ("Dokumentet e Projektit") dhe Shtojca C, Politika e SCI për mbrojtjen e fëmijës.

Palët lidhin këtë marrëveshje në frymën e *Parimeve të SCI-së për Partneritet*, e që janë: marrëdhënie që udhëhiqen nga vlerat dhe që fuqizojnë marrëdhëniet; transparencë dhe llogaridhënia; dhe përfitimi reciprok. Kopja e *Parimeve të SCI-së për Partneritetin* është në dispozicion, me anë të kërkesës.

1. **AFATI**
 - 1.1. Kjo marrëveshje do të jetë në fuqi nga 1 janari 2018 dhe do të skadojë më 31 dhjetor 2019, përveç nëse ndërpritet më herët apo zgjatet me anë të pajtueshmërisë mes të gjitha palëve me shkrim.
2. **FINANCIMI**
 - 2.1. SCI miraton ndarjen e deri në 11.650.00 €, ekuivalente me njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë euro për DKA në Gjakovë, për:
 - 2.1.1. **Mbulimin e pagës së një (1) edukatore parafillore/parashkollore që do të punojë me orar të plotë me fëmijët e moshës 3-5 dhe 5-6 vjeç në qendrën për KZHFH me bazë në komunitet brenda SHFMU "Ukshin Miftari" në Skivjan me deri në 7.650 €, ekuivalente me shtatë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë euro, për një periudhë prej shtatëmbëdhjetë (17) muajsh (01.08.2018 - 31.12.2019);**
 - 2.1.2. Ofrimin e një granti të vogël prej 4.000 €, ekuivalente me katër mijë Euro për të mbështetur zbatimin e planit zhvillimor të Institucionit Parashkollor "Ganimete Terbeshi" në Gjakovë.
 - 2.2. Pagesat dhe kthimi i fondeve sipas marrëveshjes do të bëhet në Euro.
 - 2.3. Të gjitha palët bien dakord të kryejnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre siç janë detajuar në Klauzolën 6.
 - 2.4. Objektivat dhe aktivitetet e projektit mund të rishikohen herë pas here në përputhje me kushtet e kësaj marrëveshjeje dhe të gjitha këto ndryshime do të kërkojnë pajtimin me shkrim të të gjitha palëve.
3. **PËRDORIMI I FONDEVE**
 - 3.1. Të gjitha palët në këtë marrëveshje duhet të jenë në pajtim me kushtet e donatorit, ose siç njoftohen ndryshe palët nga SCI. SCI është përgjegjëse për ofrimin e udhëzimeve për të gjitha palët në kërkesat e donatorëve nëse palët e kërkojnë këtë.
 - 3.2. Projekti Përmirësimi i qasjes dhe cilësisë për Kujdesin dhe Zhvillimin gjatë Fëmijërisë së Hershme në Kosovë, do të realizohet në përputhje me dokumentet e projektit në shtojcën A dhe B të kësaj marrëveshjeje.
 - 3.3. Çdo fond që do të ofrohet nga SCI për të mbështetur aktivitetet e palëve të tjera sipas kësaj marrëveshjeje, do të sigurohet në bazë të aktivitet-pas-aktiviteti. Buxheti i detajuar aktiviteve për të cilat SCI do të ndajë fonde për palët mund të gjendet në shtojcën B.
 - 3.4. SCI nuk do të ofrojë fonde të mëtejshme derisa të gjitha fondet e ofruara më parë të jenë regjistruar dhe çdo fond i pashpenzuar të jetë kthyer.
4. **PAGESA**
 - 4.1. Fondet sipas kësaj marrëveshjeje do të paguhën sipas mënyrës së pagesës të dakorduar nga të gjitha palët.

4.2. Objektivi specifik dhe aktivitetet e projektit janë:

Objektivi: Vajzat dhe djemtë 0-6 vjeç në Kosovë gëzojnë të drejtën e tyre për zhvillim fizik, mendor, moral dhe social, duke iu mundësuar atyre të rriten me potencialin e tyre të plotë.

Aktiviteti 1: Angazhimi i një (1) edukatoreje parashkollore/parafillore të re në qendrën e KZHFH me bazë në komunitet, për të punuar me orar të plotë në ofrimin e programeve pedagogjike cilësore të KZHFH për fëmijët 3-5 dhe 5-6 vjeç, me kurrikula parashkollore kombëtare.

Aktiviteti 2: Ofrimi i grantit të vogël për të mbështetur zbatimin e planit zhvillimor parashkollor, për të adresuar nevojat e tyre me qëllim të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve që ofrojnë.

VJ. Aktivitetet e tjera të projektit që nuk kërkojnë transferimin e fondeve nga SCI tek palët e tjera mund të gjenden në shtojcën A.

4.3. Përfitues të këtij projekti janë fëmijët 0-6 vjeç, fëmijët nga grupet e privuara, fëmijët me aftësi të kufizuara dhe fëmijët që janë të privuar nga shërbimet e KZHFH në 8 komuna të Kosovës.

4.4. Të gjitha aktivitetet e Projektit do të jenë në përputhje me ligjet dhe rregulloret e aplikueshme në Kosovë.

5. LOKACIONI I PROJEKTI

5.1. Projektet do të implementohen në Gjakovë, në:

1. SHMU "Ukshin Miftari" në Skivjan
2. IP "Ganimete Terbeshi" në Gjakovë

5.2. SCI, DKA dhe DKSHMS në Gjakovë do të bashkëpunojnë në lokacionet e cekura më lart duke u bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në këtë Marrëveshje Partneriteti.

6. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

6.1. SCI-ja do të jetë përgjegjëse për:

6.1.1. Pagesën e pagës së një (1) edukatore parashkollore/parafillore që do të punojë me orar të plotë me fëmijët e moshës 3-5 dhe 5-6 në qendrën e KZHFH brenda SHFMU "Ukshin Miftari" në Skivjan, nga dita e emërimit deri më 31 dhjetor 2019;

VJ: Përshkrimi i detyrave të punës për edukatorët parashkollore/parafillore do të përpilohet në përputhje me Udhëzimin Administrativ Nr. 06/2015 për Normativ mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm dhe në bashkëpunim të ngushtë në mes Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë DKA-së dhe SCI-së.

6.1.2. Ofrimin e grantit të vogël për të mbështetur zbatimin e planit zhvillimor të institucionit parashkollor "Ganimete Terbeshi" në Gjakovë.

VJ: Fondet e ndara për pagat e edukatoreve parashkollore/parafilllore dhe granteve të vogla do të bëhen direkt në:
Llogarinë bankare të komunës: 1000-6500-5000-0077;

Fondet e alokuara janë dedikuar ekskluzivisht për pagat mujore të edukatores parashkollore/parafilllore dhe zbatimin e planit zhvillimor, dhe nuk do të përdoren për asnjë qëllim tjetër.

- 6.1.3. Identifikimin, rehabilitimin dhe rimobilimin e hapësirës, përkatësisht një (1) klase për shërbimet e KZHFFH në SHFMU "Ukshin Miftari" në Skivjan.
- 6.1.4. Sigurimin e materialit didaktik dhe shpenzues për realizimin e aktiviteteve individuale dhe grupe në SHFMU "Ukshin Miftari" në Skivjan.
- 6.1.5. Angazhimin e një (1) mobilizuese të komunitetit për të mbështetur krijimin e shërbimeve të KZHFFH në lokacionet e projektit.
- 6.1.6. Ngritjen e kapacitetit të institucioneve edukativo-arsimore të përzgjedhura për implementimin e përvojave gjithpërfshirëse në arsim dhe eksperiencave të shërbimeve cilësore për KZHFFH që nxisin zhvillimin holistik.
- 6.1.7. Organizimin e trajnimit të nevojshëm mbi Parimet Bazike të KZHFFH për mësimdhënësit parafillorë, edukatorët parashkollorë/parafillor, mobilizueset e komunitetit dhe edukatorët e shkollave fillore dhe institucionit parashkollor të përzgjedhura, me qëllim të ngritjes së kapaciteteve në integrimin e punës së tyre përmes programit të informimit në koordinim me shërbimet tjera, siç janë qendrat për kujdesin shëndetësor primar, qendrat për mirëqenie sociale dhe vizitat në shtëpi.
- 6.1.8. Realizimin e procesit formësues të vetë-vlerësimit me edukatorët e institucionit parashkollor "Ganimete Terbeshi", për të vlerësuar 4 fushat kryesore: metodat edukative në përdorim, ekspertiza profesionale, praktikat organizative dhe struktura organizative.
- 6.1.9. Ofrimin e instrumenteve specifike për monitorimin dhe dokumentimin e zhvillimit të fëmijëve për t'u shfrytëzuar në shkollat fillore dhe institucionin parashkollor të përzgjedhura.
- 6.1.10. Organizimin e takimeve ndër-sektoriale në nivelin komunal me DKA dhe DKSHMS për të vendosur kornizën për të integruar të gjitha komponentët sektoriale (sektorin e edukimit, shëndetësisë dhe mirëqenies sociale) në ofrimin e shërbimeve KZHFFH.
- 6.1.11. Organizimin e tryezave të rrumbullakëta në nivel komunal për të identifikuar komponentët kryesore të shërbimeve KZHFFH me qëllim të planifikimit shërbime të integruara për vajzat dhe djemtë, më pjesëmarrjen e sektorëve të arsimit, shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, dhe përfaqësuesit e OSHC-ve dhe komunitetit.
- 6.1.12. Organizimin e takimeve të rregullta me të gjitha palët për të diskutuar rreth sfidave dhe progresit të Projektit.
- 6.1.13. Udhëzimin e palëve gjatë gjithë procesit dhe ofrimin e asistencës teknike me qëllim të sigurimit të menaxhimit të duhur të aktiviteteve të Projektit;
- 6.1.14. Tu siguruar që të gjitha kushtet dhe kërkesat e donatorit iu janë komunikuar qartë palëve si dhe njoftimi për çfarëdo amendamenti apo ndryshimi i këtyre kërkesave të jetë ofruar me kohë..

6.2. DKA në Gjakovë do të jetë përgjegjëse për:

- 6.2.1. Bashkëpunim të ngushtë me SCI dhe DKSHMS në implementimin e Projektit;
- 6.2.2. Organizimin e procesit të selektimit të edukatores parashkollore/parafillore në bazë të procedurave të rekrutimit të MASHT dhe DKA-së.;
- 6.2.3. Asistimin e SCI në identifikimin, rehabilitimin dhe rimobilimin e hapësirës për shërbimet e KZHFFH, respektivisht një (1) klase në SHFMU "Ukshin Miftari" në Skivjan;
- 6.2.4. Të mundësuar qasjen dhe mbështetjen e plotë për SCI në realizimin e procesit formësues të vetë-vlerësimit me edukatorët në institucionin parashkollor "Ganimete Terbeshi";
- 6.2.5. Të mundësuar qasjen dhe mbështetjen e plotë për SCI në përmirësimit të dokumentimit të zhvillimit të fëmijëve përmes procesit të bashkëpunimit me edukatorët dhe prindërit në institucionin parashkollor "Ganimete Terbeshi";
- 6.2.6. Të siguruar që një ofrues i shërbimeve të arsimit do të kontribuojë në planifikimin dhe ofrimin e:
- 6.2.6.1. Sesioneve mujore për një grup të nënave dhe fëmijëve në SHFMU "Ukshin Miftari" në Skivjan;
- 6.2.6.2. Sesioneve tremujore për një grup të prindërve në institucionin parashkollor "Ganimete Terbeshi" në Gjakovë.;
- Planifikimi dhe ofrimi i sesioneve do të bëhet në koordinim midis shërbimeve komunale të arsimit, shëndetësisë dhe mirëqenies sociale;
- 6.2.7. Të siguruar që fëmijët, mësimmhënësit parafillorë dhe edukatorët parashkollorë/parafillor të SHFMU-ve dhe institucionit parashkollor të përzgjedhur do të trajtohen në mënyrë të njëjtë me fëmijët dhe mësimmhënësit tjerë të institucioneve edukativo-arsimore;
- 6.2.8. Sigurimin e pagës, duke filluar nga 1 janari 2020, për një (1) edukatore parashkollore/parafillore që do të punojë më orar të plotë me fëmijët e moshës 3-5 dhe 5-6 në SHFMU "Ukshin Miftari" në Skivjan.
DKA do të përfshijë këto shuma në buxhetin e saj, duke filluar që nga viti 2020;
- 6.2.9. Të mundësuar qasjen dhe mbështetjen e plotë për SCI në procesin e monitorimit, mbikëqyrjes, kontrollimit dhe vlerësimit të projekteve;
- 6.2.10. Të vepruar si Drejtori udhëheqëse për takimet ndër-sektoriale koordinuese;
- 6.2.11. Sigurimin e hapësirës për realizimin e aktiviteteve të ndryshme që lidhen me Projektin;
- 6.2.12. Inkurajimin e bashkëpunimit midis mësimmhënësve, prindërve dhe fëmijëve;
- 6.2.13. Organizimin e procesit edukativo-arsimor në SHFMU dhe institucionin parashkollor të përzgjedhur;
- 6.2.14. Ndërmarrjen e masave disiplinore në institucionet edukativo-arsimore ndaj edukatoreve parashkollore/parafillore nëse ai/ajo nuk i respekton dhe përmbushë përgjegjësitë e tij/saj.
- 6.3. DKSHMS në Gjakovë do të jetë përgjegjëse për:
- 6.3.1. Bashkëpunim të ngushtë me SCI dhe DKA në implementimin e Projektit;
- 6.3.2. Identifikimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor primar dhe social dhe mundësive që do të përplotësojnë cilësinë e shërbimeve të KZHFFH që nxisin zhvillimin holistik;
- 6.3.3. Të siguruar që një ofrues i shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe një ofrues i shërbimeve sociale do të kontribuojnë në planifikimin dhe ofrimin e:
- 6.3.3.1. Sesioneve mujore për një grup të nënave dhe fëmijëve në SHFMU "Ukshin Miftari" në Skivjan;

- 6.3.3.2. Sesioneve tremujore për një grup të prindërve në institucionin parashkollor "Ganimete Terbeshi" në Gjakovë.
- Planifikimi dhe ofrimi i sesioneve do të bëhet në koordinim midis shërbimeve komunale të arsimit, shëndetësisë dhe mirëqenies sociale.
- 6.3.4. Të kontribuar në përmirësimin e dokumentimit të zhvillimit të fëmijëve me kontributin e ofruesve të shërbimeve shëndetësore të përfshirë në projekt.
- 6.3.5. Sigurimin e hapësirës për realizimin e aktiviteteve të ndryshme që lidhen me Projektin.
- 6.3.6. Të kontribuar në zhvillimin e nismës për të hartuar modelin e bazuar në komunitet dhe për të identifikuar mësimet e mësuara nga implementimi i projektit.
- 6.4. Palët pajtohen të takohen në mënyrë periodike, sipas një kalendari të dakorduar, për ta diskutuar avancimin e projektit, për të raportuar në lidhje me përgjegjësitë e tyre përkatëse sipas kësaj marrëveshjeje, për të identifikuar çdo çështje apo rrezik ndaj projektit dhe për të rënë dakord bashkërisht për mënyrën se si këto mund të adresohen.
- 6.5. Të gjitha palët pajtohen ta njoftojnë njëra-tjetrën sa më shpejt të jetë e mundur për çdo ndryshim të rëndësishëm në projekt apo për çdo vështirësi apo vonesë e cila mund të ndikojë në mënyrë të konsiderueshme në respektimin e kalendarit të propozuar dhe/ose ekzekutimin e projektit.
- 6.6. Asnjë prej palëve nuk do të jetë përgjegjëse për:
- 6.6.1. Çfarëdo pretendimi, humbjeje, apo shpenzimi të palëve të treta, të cilat do të mund të lindin nga neglizhenca, pakujdesia apo veprimi i qëllimtë apo mosveprimi i palës tjetër, i cili ndërlidhet apo është në lidhje me këtë marrëveshje.
- 6.6.2. Kompensimin për vdekjen, paaftësimin, apo rreziqe të tjera të cilat mund t'i vuajnë punonjësit, shitësit, agjentët apo përfaqësuesit e tjerë të palës tjetër, të cilat lindin nga performanca e palës tjetër në lidhje me këtë Marrëveshje.
- 7. BURIMET E PROJEKTIT**
- 7.1. SCI-ja do të kontribuojë me burimet e lartcekura në bashkëpunim me DKA në Gjakovë.
- 7.2. Pronësia e të gjitha aseteve, pajisjeve dhe artikujve të inventarit, të blera nga DKA dhe/apo DKSHMS duke përdorur fondet e projektit ose të ofruara nga SCI, mbetet pronë e SCI, përveç nëse specifikohet ndryshe në këtë marrëveshje ose në kushtet e donatorëve. SCI rezervon të drejtën për të disponuar asetet, pajisjet ose inventarin e tillë siç e gjykon të arsyeshme, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, dorëzimin e sendeve të tilla tek institucionet përfituese të projektit, komuniteti apo përfituesit.
- 8. RAPORTET, MONITORIMI DHE VLERËSIMI**
- 8.1. Raportet e rregullta tremujore financiare për pagën mujore të edukatoreve parashkollore/parafilllore do të përgatiten nga DKA në Gjakovë dhe do t'i dorëzohen SCI-së.
- 8.2. Projekt propozimet e granteve të vogla nga qendrat e KZHFH me bazë në komunitet dhe institucioni parashkollor do të miratohen nga SCI.

- 8.3. Raportet financiare përfundimtare për zbatimin e granteve të vogla do të përgatiten nga DKA në Gjakovë dhe do t'i dorëzohen SCI-së.
- 8.4. Monitorimi i zbatimit të aktivitetit do të bëhet në baza të rregullta mujore nga DKA në Gjakovë dhe SCI.
- 8.5. SCI do të monitorojë punën e edukatoreve parashkollore/parafillore të paguar nga fondet e saj dhe do t'i raportojë DKA-së në Gjakovë çdo vërejtje në lidhje me punën e tij/saj.
- 8.6. Ekipi i monitorimit do të përbëhet nga përfaqësues nga personeli i DKA në Gjakovë dhe personeli i SCI i cili do të jetë gjithashtu përgjegjës për rishikimin vjetor.
- 8.7. Vlerësimi përfundimtar i projektit do të zhvillohet nga përfaqësues të DKA në Gjakovë dhe SCI.

9. NDRYSHIMET

- 9.1. Çdo modifikim apo shtesë e kësaj marrëveshjeje do të kërkojë një amendament. Cilado prej palëve mund të sugjerojë amendamente.

Amendamenti duhet të miratohet me shkrim nga nënshkruesit e marrëveshjes.

10. KLAUZOLA KUNDËR MASHTRIMIT DHE KORRUPSIONIT

- 10.1. Të gjitha palët zotohen për të vepruar në mënyrë transparente në të gjitha aspektet e këtij projekti dhe për të marrë të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur nga mashtrimi apo keqpërdorimi kontributet e bëra në drejtim të këtij projekti.
- 10.2. Të gjitha palët konfirmojnë se ato do të veprojnë në pajtim me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi që lidhen me mos dhënien e mitos dhe kundër korrupsionit, duke përfshirë, por pa u kufizuar vetëm në Ligjin e Mbretërisë së Bashkuar Kundër Ryshfetit, të vitit 2010, dhe se nuk do të angazhohen në asnjë aktivitet, praktikë apo sjellje që do të përbënte vepër penale në bazë të Ligjit të Mbretërisë së Bashkuar kundër Ryshfetit, të vitit 2010, apo Ligjit kundër korrupsionit në Kosovë.

11. POLITIKA PËR MBROJTJEN E FËMIJËS

- 11.1. Si organizatë për të drejtat e fëmijëve, Save the Children ka detyrën të kujdeset për të gjithë fëmijët me të cilët ajo është në kontratë qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë, qoftë përmes partneriteteve kontraktuale. Për shkak se Save the Children përqendrohet në mënyrë të veçantë në abuzimin e fëmijëve dhe shfrytëzimin e tyre seksual nga ana e personelit të saj apo personelit të çdo organizate/organi i cili lidhet me aktivitetet e saj, organizata i **kërkon** anëtarëve të personelit të saj, sipas Termave dhe Kushteve të kontratave të tyre, që t'i raportojnë menjëherë shqetësimet apo dyshimet.
- 11.2. Prandaj, në kuadër të kësaj marrëveshjeje, çdo shqetësim apo deklaratë për abuzim të fëmijëve apo shfrytëzimit për qëllime seksuale të drejtuara kundër ndonjë anëtar të personelit të DKA-së dhe DKSHMS-së në Gjakovë, i cili është i lidhur me aktivitetet që mbulohen nga kjo marrëveshje, do të raportohet formalisht tek menaxheri i lartë

përkatës brenda agjencisë qeveritare, në pajtim me procedurën e dakorduar për raportim.

- 11.3. Do të jetë pritshmëria e Save the Children që, në rast të plotësimit të një raporti të tillë, raporti të trajtohet me emergjencën më të madhe dhe të hetohet/menaxhohet si duhet dhe në interesat më të mirë të çdo fëmije (fëmijëve) të përfshirë. Save the Children do të ishte në gjendje të ofrojë këshilla teknike/mbështetje për këtë proces nëse nevojitet/kërkohet.
- 11.4. Në të njëjtën mënyrë, Save the Children pret që DKA dhe DKSHMS në Gjakovë të raportojë çdo shqetësim apo dyshim që ai vetë mund të ketë që ndonjë prej anëtarëve të personelit apo përfaqësues të Save the Children mund të jetë duke abuzuar apo shfrytëzuar seksualisht ndonjë fëmijë apo fëmijët me qëllim që të ndërmerren veprime të menjëhershme, në pajtim me procedurat e brendshme të organizatën për këto veprime.

12. SHTOJCAT

Shtojcat e mëposhtme janë pjesë e kësaj marrëveshjeje.

Shtojca A	Përshkrimi i projektit (duke përfshirë objektivat e projektit, rezultatet dhe aktivitetet)
Shtojca B	Buxheti
Shtojca C	Politika e SCI-së për Mbrojtjen e Fëmijëve

Nënshkrimi dhe pranimi i SCI-së


Për dhe në emër të SCI

Emri: Ahmet Kryeziu

Titulli: Drejtor vendor

Nënshkrimi: _____

Data: _____



23.09.2018

Nënshkrimi dhe pranimi i partnerëve

Për dhe në emër të DKA-së në Gjakovë

Emri: Bernard Frrokaj

Titulli: Drejtor i DKA

Nënshkrimi: _____

Data: _____



19.07.2018

Për dhe në emër të DKSHMS-së në Gjakovë

Emri: Adelina Shehu Kola

Titulli: Drejtoreshë e DKSHMS

Nënshkrimi: _____

Data: _____



07-10/18



Shtojca A
Përmbledhje e projektit

Project name: Përmirësimi i qasjes dhe cilësisë në Kujdesin dhe zhvillimin gjatë fëmijërisë së hershme në Kosovë

Periudha implementuese: 01.01.2018 - 31.12.2019

Lokacionet e projektit: Prishtinë, Ferizaj, Gjiilan, Gjakovë, Pejë, Mitrovicë jugore, Klinë dhe Junik.

Grupet e shënjestruara: Fëmijët 0-6 vjeç; fëmijët nga grupet e cënueshme, fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët e privuar nga shërbimet e Kujdesit dhe zhvillimit gjatë fëmijërisë së hershme (KZHFH) në 8 komuna të Kosovës.

Përmbledhje e projektit: Ky projekt do të shtrijë zbatimin e praktikave më të mira të krijuara gjatë periudhës 2015-2017, në përmirësimin e qasjes dhe cilësisë të shërbimeve në KZHFH për fëmijët e privuar 0-6 vjeç në 8 komuna.

E gjithë ndërhyrja/zbatimi i projektit është i bazuar në pesë komponentët kryesorë në vijim:

1. Ngritja e kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve në fushën e arsimit, shëndetësisë dhe mirëqenies sociale
2. Integrimin e komponenteve të arsimit, shëndetësisë dhe mirëqenies sociale në shërbimet e KZHFH
3. Rehabilitimi dhe pajisja
4. Rrjetëzimi dhe koordinimi
5. Avokimi dhe vetëdijesimi

Objektivi i përgjithshëm:

Vajzat dhe djemtë 0-6 vjeç në Kosovë gëzojnë të drejtën e tyre në zhvillim fizik, mendor, moral dhe social, duke iu mundësuar atyre të rriten me potencialin e tyre të plotë.

Objektivi specifik:

Vajzat dhe djemtë 0-6 vjeç në 8 komuna kanë qasje në shërbime cilësore të KZHFH të cilat nxisin zhvillimin e tyre të gjithanshëm (holistik).

Rezultati 1:

Vajzave dhe djemve 0-6 vjeç; në veçanti atyre nga grupet më të cënueshme, iu është përmirësuar qasja në mjedise mësimore cilësore dhe stimuluese.

Rezultati 2:

Shërbimet ekzistuese të KZHFH për vajza dhe djem 0-6 vjeç janë të cilësisë së lartë dhe përmbajnë të kuptuarit e gjithanshëm (holistik) të nevojave të fëmijëve dhe pjesëmarrjes së prindërve.

Rezultati 3:

Vetëdije dhe përkushtim i rritur mes komuniteteve, autoriteteve komunale dhe institucioneve kombëtare për ofrimin e shërbimeve cilësore të KZHFH.

Aktivitetet: 1.1. Organizimi i takimit inicues me palët e interesit dhe nënshkrimi i Marrëveshjeve të partneritetit me 8 komunat për themelimin e 6 qendrave të reja për KZHFH me bazë në komunitet në viset rurale, si dhe mbështetjen e 8 institucioneve parashkollore ekzistuese në viset urbane. 1.2. Organizimi i punëtorive me palët e interesit në nivel lokal dhe qendror rreth modelit të KZHFH me bazë në komunitet dhe shërbimeve të integruara. 1.3. Identifikimi, rehabilitimi dhe rimobilimi i hapësirave të qendrave të KZHFH me bazë në komunitet. 1.4. Ofrimi i materialeve didaktike për aktivitetet e KZHFH në 10 qendrat e KZHFH me bazë në komunitet. 1.5. Angazhimi i 6 edukatoreve parashkollore/parafillore dhe 7 mobilizuesve të komunitetit për shërbime të KZHFH me bazë në komunitet. 1.6. Hartimi, përkthimi dhe printimi i <i>Pakos udhëzuese për fasilitatorë</i> për ofrimin e sesioneve të KZHFH për prindër. 1.7. Ofrimi i trajnimeve për të ngritur kapacitetet e 10 edukatoreve parashkollore/parafillore dhe 7 mobilizuesve të komunitetit për organizimin dhe themelimin e shërbimeve të KZHFH. 1.8. Fasilitasi i sesioneve të KZHFH për nëna dhe fëmijë në (së paku nga 5 në vit për secilën nga viset rurale) bazuar në <i>Pakon udhëzuese për fasilitatorë</i>. 1.9. Komunitetet shkëmbyese rrjetëzuese me profesionist të	Aktivitetet: 2.1. Organizimi i tryezave të rrumbullakëta rreth shërbimeve të integruara të KZHFH me shërbyesit e arsimit, shëndetësisë dhe mirëqenies sociale në 6 komuna. 2.2. Fasilitasi i punëtorive për vetë-vlerësim me edukatorët dhe administratorët parashkollor në 8 insitucionet parashkollore për të informuar planet zhvillimore parashkollore. 2.3. Ofrimi i granteve të vogla për të mbështetur zbatimin e planeve zhvillimore parashkollore. 2.4. Fasilitasi i sesioneve mbi KZHFH për prindër në viset urbane duke u bazuar në <i>Pakon udhëzuese për fasilitatorë</i>. 2.5. Fuqizimi i dokumentimit të zhvillimit të fëmijëve dhe printimi i Protokollit të Vëzhgimit (në baza vjetore). 2.6. Dizajnimi dhe printimi i 1 moduli të trajnimit për edukatore që punojnë me fëmijë 0-3 vjeç. 2.7. Ofrimi i 3 moduleve të trajnimit në KZHFH për edukatore që punojnë me fëmijë 0-3 vjeç në 7 komuna.	Aktivitetet: 3.1. Organizimi i një takimi avokues për çdo komunë (gjithsej 6 takime) në baza vjetore, lidhur me qëndrueshmërinë e modeleve të KZHFH me bazë në komunitet për vajzat dhe djemtë 0-3 dhe 3-6 vjeç. 3.2. Organizimi i fushatës vjetore vetëdijesuese mbi rëndësinë e KZHFH. 3.3. Organizimi i konferencës kombëtare/rajonale mbi rëndësinë e KZHFH.
---	--	--

arsimit, shëndetësisë dhe mirëqenies sociale. 1.10. Ofrimi i granteve të vogla për 4 qendrat ekzistuese të KZHFH me bazë në komunitet.		
---	--	--

Shtojca B
Buxheti

Përmirësimi i qasjes dhe cilësisë në KZHfH në Kosovë	Të gjitha vitet (2018-2019)				Viti 2018			Viti 2019		
	Njësia	Çmimi për njësi	Sasia	Gjithsej	Njësia	Çmimi për njësi	Sasia	Njësia	Çmimi për njësi	Sasia
Periudha implementuese: 01.01.2018 - 31.12.2019 Nr. Përkshkrimi i aktivitetit Mbulimi i pagës së një (1) edukatore parafilllore/parashkollore që do të punojë me orar të plotë me fëmijët e moshës 3-5 dhe 5-6 vjeç në qendrën për KZHfH me bazë në komunitet brenda SHFMU "Ukshin Miftari" në Skivjan	Muaj	450.00	17	7,650.00	Muaj	450.00	5	Muaj	450.00	12
1										
2	Grant	4,000.00	1	4,000.00				Grant	4,000.00	1
				GJITHSEJ: 11,650.00	NËN-TOTAL: 2,250.00			NËN-TOTAL: 9,400.00		



SHTOJCA C

Politika e mbrojtjes së fëmijëve

Ky dokument i përcakton politikat dhe procedurat e vendosura për të siguruar që Save the Children International të njihet si një organizatë për mbrojtjen e fëmijëve. Zbatimi i kësaj politike është mjeti më të cilin Save the Children International siguron se është në përputhje me Protokollin e Save the Children International për Mbrojtjen e Fëmijëve, si dhe me Buletinin e Sekretarit të Përgjithshëm të KB mbi Masat të Posaçme për Mbrojtjen nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual 2003.

1. Ndërgjegjësimi dhe Parandalimi

PËRHAPJA DHE NGRITJA E NDËRGJEGJËSIMIT

1.1 Politika e Mbrojtjes së Fëmijëve, Kodi i Mirësjelljes, dhe Procedurat Lokale duhet të vëhen në dispozicion të gjerë për të gjithë personelin, përfaqësuesit e tjerë, personelin e agjencive partnere.

1.2 Shpërndarja duhet të mbështetet atëherë sa për të siguruar që janë kuptuar Politika e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Kodi i Mirësjelljes: kjo do të përfshijë përdorimin e përkthimit në gjuhët lokale, induksionin, trajnimin, posterët, karta të versioneve të njohura, imazhet piktoreske dhe materialin miqësor të fëmijëve.

REKRUTIMI DHE SELEKSIONIMI

1.3 Rekrutimi dhe seleksionimi i personelit dhe të tjerëve duhet të pasqyrojë angazhimin e Save the Children për të mbrojtur fëmijët, duke u siguruar se paralajmërimet, kontrollet dhe procedurat për t'i shmangur të gjithë ata që mund të jenë të papërshtatshëm për të punuar me fëmijët janë funksionale.¹

1.4 Kandidatët e suksesshëm duhet të vetëdijesohen për natyrën themelore dhe të detyrueshme të kësaj politike, procedurave dhe kodeve të mirësjelljes dhe për faktin që ato zbatohen në mënyrë të barabartë në jetën personale dhe profesionale.

STRUKTURIMI I MBROJTJES SË FËMIJËVE NE SISTEMET DHE PROCESET E MENAXHIMIT

1.5 Politika e Mbrojtjes së Fëmijëve duhet të përfshihet në të gjitha sistemet, procedurat standarde të veprimit dhe proceset që kanë ndonjë ndikim në mbrojtjen e fëmijëve në mënyrë që të krijohet një mjedis ku respektohen të drejtat e fëmijëve dhe ku nuk tolerohet abuzimi i fëmijëve dhe shfrytëzimi seksual i fëmijëve.

1.6 Politika e Mbrojtjes së fëmijëve duhet të reflektohet në të gjitha marrëveshjet e burimeve njerëzore dhe të menaxhimit që përcaktojnë se si personeli dhe përfaqësuesit e tjerë e kryejnë punën e tyre, duke përfshirë përshkrimet e punës, Procedurat Standarde të Veprimit, kushtet e referencës, kontratën e punës, kodet e mirësjelljes, sistemet e menaxhimit të performancës dhe procedurat disiplinore. Dështimi për t'ju përmbajtur aspekteve për mbrojtjen e fëmijëve të cilësdo marrëveshje të tillë duhet të njihet si shkelje e rëndë disiplinore.

1.7 Fëmijët dhe kujdestarët e tyre duhet të bëhen të vetëdijshëm për sistemet ekzistuese për të ngritur një shqetësim ose një ankesë. Si aktorë kryesorë duhet të jenë në dijeni të Politikës së Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Kodit të Mirësjelljes dhe për atë se çka ata mund të presin në kuptim të sjelljes së personelit, të përfaqësuesve të tjerë dhe partnerëve ndaj tyre. Materialet miqësore të fëmijëve duhet të përdoren për të komunikuar këto mesazhe.

¹ Shih masat e parandalimit dhe ndërgjegjësimin në Udhëzimin Plotësues

1.8 Ku Save the Children International është përgjegjëse për ofrimin e veprimtarive apo shërbimeve për fëmijët ata në çdo kohë do ti mbikëqyrin dhe mbrojnë ata sipas aftësive tona më të mira. Cilësia e këtyre shërbimeve dhe aktiviteteve duhet të reflektojnë parimet dhe procedurat e Politikës së Mbrojtjes së Fëmijëve.

VLERËSIMI I RREZIKUT DHE MENAXHIMI I RREZIKUT

1.9 Duhet të vlerësohen të gjitha aktivitetet brenda Save the Children International për të siguruar se janë identifikuar të gjitha rreziqet dhe se janë zhvilluar kontrollet e duhura. Këto aspekte duhet të përfshihen në kuadër të kornizës së Monitorimit dhe Vlerësimit për aktivitete të tilla.

1.10 Të gjitha aktivitetet, përfshirë edhe kontaktin me fëmijët përmes përdorimit të teknologjive të informacionit, duhet të vlerësohen për të siguruar që janë identifikuar të gjitha rreziqet për mbrojtjen e fëmijëve dhe se janë zhvilluar kontrollet e duhura. Këto aspekte duhet të përfshihen në kuadër të kornizës së Monitorimit dhe Vlerësimit për aktivitete të tilla.

1.11 Angazhimi me fëmijët dhe kujdestarët e tyre për qëllime të marketingut, media / komunikimit, pjesëmarrjes dhe avokimit duhet të bëhet me pëlqimin e informuar, dhe nuk duhet ta shfrytëzojnë fëmijën ose kujdestarin, e as ta rritë ndjeshmërinë e tyre, apo ti vë ata në rrezik. Duhet të zhvillohen kontrole adekuate për aktivitete të tilla dhe të ndjeken udhëzimet e identikuara praktike.

MËSIMI DHE ZHVILLIMI

1.12 Për të zhvilluar shkathtësitë e mbrojtjes së fëmijëve dhe njohuritë dhe eksperiencën e duhur për rolin e tyre në organizatë personeli, përfaqësuesit dhe personeli i agjencive partnere duhet të mbështetet. Personeli që e ka përgjegjësi që të përgjigjet për fëmijët e zbuluar të abuzimit dhe shfrytëzimit seksual, duhet të merr trajnim të veçantë në pranimin dhe përgjigjen e zbulimit.

1.13 Të kuptuarit e Politikës së Mbrojtjes së Fëmijëve (duke përfshirë Kodin e Mirësjelljes dhe Procedurat Lokale) duhet të përfshihen në induksionin dhe trajnimin e detyrueshëm / bazë për personelin dhe përfaqësuesit e tjerë. Ndjeshmëria për dhe të kuptuarit e rrethanave lokale dhe kulturës duhet të përfshihen në të mësuarit dhe në trajnim pa i falur aktet që janë të dëmshme për fëmijët.²

PARTNERËT

1.14 Të gjitha marrëveshjet në mes të Save the Children International dhe organizatave partnere duhet të përfshijnë marrëveshjen për Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve.

1.15 Agjencitë partnere duhet ta miratojnë këtë Politikë të Mbrojtjes së Fëmijëve ose ta zhvillojnë politikën e tyre të një standardi dhe qasje të ngjashme. Marrëveshjet me partnerët duhet qartë të përshkruajnë procedurat e dakorduara për e raportimin dhe hetimin e shqetësimeve që përfshijnë shkeljet e politikës. Shkeljet brenda agjencive partnere duhet të raportohen tek Save the Children.

1.16 Save the Children International duhet të ketë plane të qarta për zhvillimin e kapaciteteve të organizatave partnere në këtë fushë për të zhvilluar politikat e standardet, politikat bazë dhe procedurat me duke shfrytëzuar burimet e zhvilluara nëpër lëvizjen Save the Children.³

TEKNOLOGJITË E INFORMIMIT DHE KOMUNIKIMIT

1.17 Është funksional Udhëzimi që rregullon përdorimin e duhur të teknologjive të informimit dhe komunikimit të tilla si interneti, faqet e internetit, faqet e rrjeteve sociale, fotografitë dixhitale për të siguruar se fëmijët nuk janë vënë në rrezik është në vend. Ky udhëzim duhet të mbulojë edhe

² Shih Udhëzimin Plotësues: Udhëzimi i Personelit për Traditat Kulturorë

³ Për shembull standardet si Materialet e Ruajtjes së Sigurt të Fëmijës I, në dispozicion në www.keepingchildrensafe.org.uk.

përdorimin e këtyre teknologjive nga personeli ynë dhe përfaqësuesit, si dhe fëmijët që shfrytëzojnë teknologjitë në emër tonë ose në përgjigje të një kërkesë nga organizata jonë
SJELLJA NDAJ FËMIJËVE

1.18 Personeli, partnerët dhe përfaqësuesit e tjerë nuk duhet asnjëherë të:

1. Godasin ose në ndonjë mënyrë tjetër fizike t'i sulmojnë apo t'i abuzojnë fëmijët
2. Përfshihen në aktivitet seksual ose të kenë marrëdhënie seksuale me askënd nën moshën 18 vjeç, pavarësisht nga mosha/pëlqimi i shumicës tradita lokale. Besimi i gabuar në moshën e një fëmije nuk është mbrojtje.
3. Zhvillojnë marrëdhënie me fëmijë të cilat në qfarëdo mënyre mund të konsiderohen si shfrytëzuese apo abuzive
4. Të veprojnë në mënyra që mund të jenë abuzive në ndonjë mënyrë ose mund të vendosin fëmijën në rrezik nga abuzimi.
5. Përdorin gjuhën, të bëjnë sugjerime ose të ofrojnë këshilla të cilat janë të papërshtatshme, ofenduese apo abuzive
6. Sillen fizikisht në një mënyrë që është e papërshtatshme ose seksualisht provokative
7. Marrin fëmijën / fëmijët me të cilët ata janë duke punuar për të qëndruar gjatë natës në shtëpinë e tyre pa mbikëqyrje përveç rasteve kur i aplikojnë rrethanat e jashtëzakonshme dhe kur është marrë leja paraprake nga menaxheri i linjës së tyre
8. Fle në të njëjtin shtrat si fëmija me të cilët ata janë duke punuar
9. Fle në të njëjtën dhomë si fëmija me të cilin ata janë duke punuar përveç rasteve kur i aplikojnë rrethanat e jashtëzakonshme dhe kur është marrë leja paraprake nga menaxheri i linjës së tyre
10. Bëjnë gjëra të natyrës personale për fëmijët të cilat ata mund ti bëjnë vet
11. Tolerojnë, ose të marrin pjesë në sjelljen e fëmijëve e cila është e paligjshme, e pasigurtë ose abuzive
12. Veprojnë në mënyra të destinuara për ti, turpëruar, nënqmuar ose degraduar fëmijët, ose ndryshe bëjnë ndonjë formë të abuzimit emocional
13. Diskriminojnë, tregojnë trajtim të padrejtë diferencial ose nder fëmijëve të caktuar duke i përjashtuar të tjerët.
14. Kalojnë kohë të tepërt vetëm me fëmijët larg nga të tjerët
15. Vënë veten në një pozicion ku ata bëhen të ndjeshëm për pohimet për shkelje

Kjo nuk është një listë përfundimtare ose ekskluzive. Personeli partnerët dhe përfaqësuesit e tjerë duhet gjatë gjithë kohës të shmangin veprimet ose sjelljet të cilat mund të lejojnë që sjellja të keqinterpretohet, të përbën praktikë të dobët apo sjellje potencialisht abuzive.

1.19 Është e rëndësishme për të gjithë personelin, partnerët dhe përfaqësuesit e tjerë në kontakt me fëmijët të:

- a. Të jenë të vetë dijsëm për situatat që mund të paraqesin rrezik dhe menaxhojnë ato.
- b. Planifikojnë dhe organizojnë punën dhe vendin e punës në mënyrë që të minimizojnë rreziqet
- c. Jenë të dukshëm në punën me fëmijët për aq sa të jetë e mundur,
- d. Të sigurohen që ekziston një kulturë e hapur për të mundësuar qfarëdo çështjesh apo shqetësimesh të ngriten dhe diskutohen
- e. Të sigurohen që ndjenja e përgjegjësisë midis personelit në mënyrë që praktika të varfër apo sjellje potencialisht abuzive nuk kalon pa u kundërshtuar
- f. Bisedojnë me fëmijët rreth kontaktit të tyre me personelin ose të tjerët dhe për të inkurajuar ata për të ngritur ndonjë shqetësim
- g. Fuqizojnë fëmijët - të diskutojnë me ta për të drejtat e tyre, çka është e pranueshme dhe e papranueshme, dhe çka mund të bëjnë ata nëse ka problem.
- h. Ruajnë standardet e larta personale dhe profesionale
- i. Respektojnë të drejtat e fëmijëve dhe ti trajtojnë ata në mënyrë të drejtë, me ndershmëri, me dinjitet dhe respekt
- j. Inkurajojnë praktikën e pjesëmarrjes me fëmijët që zhvillon kapacitetet e mbrojtjes së tyre

2. Raportimi dhe Përgjigja

SISTEMI I CENTRALIZUAR

2.1 Save the Children International do të krijojë një sistem të centralizuar, në mënyrë që shqetësimet e identifikuar dhe të përgjigjura në nivel lokal do të raportohen, regjistrohen dhe analizohen në mënyrë qendrore. Përveç kur është e nevojshme në këto raste do të hetohen dhe menaxhohet nga qendra. Këto shënime duhet të raportohen tek menaxherët e lartë dhe tek të besuarit bamirës në baza të rregullta.

PROCEDURA LOKALE E RAPORTIMIT⁴

2.2 Çdo Zyrë Vendore / Rajonale duhet t'i zhvillojë procedurat e raportimit për të identifikuar se çfarë, si dhe kur janë raportuar shqetësimet. Procedura e raportimit duhet të përshkruajë në disa detaje zinxhirin e veprimeve që do të ndiqen kur është ngritur shqetësimi. Procedura e raportimit duhet të dallojë në mes incidenteve të cilat e kanë origjinën e tyre jashtë organizatës dhe ato të cilat përfshijnë personelin, përfaqësuesit e tjerë dhe partnerët, si dhe ato ku autorët e dyshuar janë vetë fëmijët.

2.3 Procedurat lokale duhet të përfshijnë udhëzimet e dakorduara të menaxhimit lidhur me kur dhe si ti raportojnë shqetësimet tek autoritetet kombëtare të tilla si Policia ose Ministrinë / Autoritetet lokale /kombëtare (për shembull ku është kryer një vepër e supozuar). Përveç kësaj ato do të përfshijnë detajet e infrastrukturës lokale të mbrojtjes së fëmijëve, ato të çështjeve lokale të abuzimit të shqetësimit të veçantë dhe të burimeve lokale të mbrojtjes së fëmijëve të cilat janë në dispozicion.⁵

2.4 Këto procedura duhet të hartohen pas përfundimit të ushtrimit të hartës, për të cilin është dhënë udhëzimi.⁶

DETYRA E GJITHË PERSONELIT DHE PËRFAQËSUESVE TË TJERË PËR TË RAPORTUAR SHQETËSIMET

2.5 I gjithë personeli i Save the Children, përfaqësuesit e tjerë dhe personeli i agjencive partnere duhet t'i raportojnë të gjitha shqetësimet duke përfshirë të dyja edhe raportet specifike edhe

⁴ Termi "lokale" do të ndryshojë, në disa lokacione do t'i referohet procedurave të të gjithë vendit, për disa do t'i referohet personelit dhe mjedisit të Zyrës Rajonale dhe për të tjerët mund të jetë e limituar për nën degët/zyrat.

⁵ Udhëzime për procedurën Lokale dhe Modelin e Hartës

⁶ Udhëzime për procedurën Lokale dhe Modelin e Hartës

⁷ Termi "serioz" është përdorur në lidhje me keqtrajtim të qëllimshëm e mizor apo të pazakontë të fëmijëve dhe ka për qëllim për të dalluar këto incidente nga dhuna e përhapur e nivelit të ulët ndaj fëmijëve që është një tipar për keqardhje i disa shoqërive. Këto u referohen incidenteve të një natyre të qëllimshme të parandalueshme e cila përbën një krim kundër fëmijëve në ligjin vendor. Për shembull, në mjediset ku ndëshkimi fizik mbetet një formë e zakonshme e disiplinës, dënimi ekstrem duke përfshirë përdorimin e mjeteve dhe dënimit i cili shkakton gjakderdhje, mavijosje dhe thyerje të kockave duhet të raportohet brenda këtyre procedurave.

⁸ Kjo mund të jetë në projekt, në zonën e fushës lokale, fushën rajonale, zyrë ose nivele vendore në varësi të madhësisë, shtrirjes dhe vlerësimit se sa më shumë bëhet sistemi efektiv.

⁹ Pika e kontaktit për Mbrojtjen e Fëmijëve është term i përdorur për anëtarin e personelit i cili është përgjegjës për pranimin e shqetësimeve ose ankesave. Këta janë anëtarë kyç të personelit që duhet të emërohen në këtë rol dhe të trajnohen dhe mbështeten në marrjen e detyrave të tyre.

shqetësimet e pakonfirmuara lidhur me abuzimin e fëmijëve ose shfrytëzimin seksual, ku autori i dyshuar është anëtar i personelit, përfaqësues tjetër ose personel i agjencisë partnere.

2.6 Prioritet i parë i çdo anëtarit të personelit të cilit i janë raportuar shqetësimet për mbrojtjen e fëmijëve duhet të jetë siguria dhe mirëqenia e menjëhershme e fëmijës.

2.7 Procedurat lokale duhet poashtu të përfshijnë edhe procedurat që i mundësojnë personelit për të raportuar dhe për t'iu përgjigjur akuzave të rënda të abuzimit dhe shfrytëzimit seksual ku autorët e dyshuar shtrihen jashtë organizatës, përfaqësuesve e saj ose partnerëve.

2.8 Shqetësimet për Mbrojtjen e Fëmijëve duhet të raportohen brenda 24 orëve, përveç nëse është e pamundur apo jopraktike për të bërë këtë apo ekzistojnë rrethana të tjera të veçanta.

2.9 Procedurat duhet të jenë lehtësisht të arritshme, të njohura dhe të kuptuara nga i gjithë personeli, përfaqësuesit dhe personeli e agjencive partnere.

ROLET DHE PËRGJEGJËSITË PËR ZBATIMIN E POLITIKËS SË MBROJTJES SË FËMIJËVE

2.10 "Pikat e Kontaktit të Mbrojtjes së Fëmijëve", p.sh. anëtarët e caktuar të personelit për të pranuar shqetësimet / ankesat për Mbrojtjen e Fëmijëve duhet të emërohen nga Drejtori Vendor në nivelet e përshtatshme të njësive gjeografike / operative⁷

2.11 Personeli i nominuar në poste kyçe duhet ta ketë qartë të identifikuar rolin dhe përgjegjësitë e tyre në Mbrojtjen e Fëmijëve. Kjo duhet të përfshijë rolet dhe përgjegjësitë e personelit në ngritjen e shqetësimeve / ankesave të Mbrojtjes së Fëmijëve, pikat e kontaktit në mbrojtjen e fëmijëve për pranimin e shqetësimeve / ankesave dhe menaxherët për t'iu përgjigjur ndaj dhe menaxhuar këto çështje. Pozitat e tilla duhet të marrin trajnimin e udhëzimeve të duhura dhe mbështetje.

2.12 I gjithë personeli, përfaqësuesit, dhe personeli i agjencive partnere duhet të jenë të vetëdijshëm për detajet e pikës së kontaktit për pranimin e shqetësimeve / ankesave të mbrojtjes së fëmijëve.

2.13 Forma standarde e raportimit duhet të përdoret për raportimin e shqetësimeve (Forma për raportimin e Mbrojtjes së Fëmijës (Child Safeguarding reporting form)). Veprimi duhet të nxitet nga personat e identifikuar në përputhje me Procedura Lokale.

POLITIKA E FISHKËLLIMËS SË PIPIT (WHISTLEBLOWING POLICY)

2.14 Politika e Save the Children International për Fishkëllimën e Pipit (WHISTLEBLOWING POLICY) do të shfrytëzohet kur personeli ka një besim të vërtetë se është rrezikuar Politika e Mbrojtjes së Fëmijëve. (P.sh. kur personi tek i cili ata do ta raportojnë shqetësimin është vetë subjekt i shqetësimit).

PARIMET DHE PRAKTIKA NË PËRGJIGJE TË AKUZAVE PËR ABUZIME APO SHFRYTËZIM SEKSUAL

2.15 Në përgjigje ndaj akuzave të abuzimit të fëmijëve apo shfrytëzimit seksual të fëmijëve, personeli dhe menaxherët duhet të udhëzohen nga Procedurat e Përgjithshme të Save the Children për Ballafaqim me Abuzimin ose Shfrytëzimin e Dyshuar. Këto e përcaktojnë një grup të qartë të parimeve që përqëndrohen në interesat më të mira të fëmijës, si dhe çështjet e mbrojtjes dhe të sigurisë, shëndetin dhe mirëqenien fizike dhe psikologjike dhe respektin për të drejtën e konfidencialitetit, barazisë dhe qasjes në drejtësi.

Procedura e aranzhimeve në partneritet

PROCEDURA E MBROJTJES SË FËMIJËVE TË SAVE THE CHILDREN


PROCEDURA E ARANZHIMEVE NË PARTNERITET Për shfrytëzim nga Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Drejtoria Komunale e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Gjakovë

Faza 1

Të respektohen nga organizata partnere

Në rast të zbulimit, incidentit apo brengës për abuzim apo rrezik të abuzimit të fëmijëve të përfshirë në projektet e përbashkëta të Save the Children:

Në të njejtën kohë :



Vërtetohet se përkthimi është identik me dokumentin në gjuhën angleze.

Faza 3

Dërgoni feedback tek Save the Children për veprimet/rezultatet – normalisht brenda tre muajsh.

Marrëveshja e Aranzhimeve në Partneritet mbi Procedurën e Përbashkët

PROCEDURA E MBROJTJES SË FËMIJËVE TË SAVE THE CHILDREN

MARRËVESHJA E ARANZHIMEVE NË PARTNERITET MBI PROCEDURËN E PËRBASHKËT

Partneri: Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjakovë (DKA)

Emri: Bernard Frrokaj

Titulli: Drejtor i DKA

Partneri: Drejtorisë Komunale e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Gjakovë (DKSHMS)

Emri: Adelina Shehu Kola

Titulli: Drejtoreshë e DKSHMS

Save the Children

Emri: Ahmet Kryeziu

Titulli: Drejtor Vendor

Ne pajtohemi të respektojmë procedurën e përbashkët të MBROJTJES SË FËMIJËVE të bashkangjitur

Nënshkruar:

(për: **Drejtorinë Komunale të Arsimit në Gjakovë**)

Datë:

19.07.2018.

Nënshkruar:

(për: **Drejtorinë Komunale të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Gjakovë**)

Datë:

19-07-2018

Nënshkruar:

(për: **Save the Children**)

Datë:

23.07.2018

Kopjet e Marrëveshjes së Aranzhimeve në Partneritet mbi Procedurën e Përbashkët të mbahen nga të dy organizatat.

Të dy organizatat posedojnë të drejtën që në mënyrë të pavarur të referojnë brengat mbi mbrojtjen e fëmijëve tek autoritetet e përkatëse nëse shfaqen mosmarrëveshje mbi veprimet që duhet të ndërmerren me qëllim të mbrojtjes së fëmijëve.

2.16 I gjithë personeli Ndërkombëtar i Save the Children, përfaqësuesit e të tjerë dhe agjencitë partnere do të veprojnë në mënyrë të përshtatshme dhe efektive në procesin e hetimeve të ndonjë hetimi apo bashkëpunimi operativ me ndonjë proces të mëvonshëm të hetimit, dhe do të udhëhiqen nga parimi i veprimit në 'interesi më të mirë e fëmijës' në çdo proces të tillë si dhe nga Procedurat e Përgjithshme për Ballafaqim me Abuzimin ose Shfrytëzimin e Dyshuar..

2.17 Personelit do t'i kërkohet që të bashkëpunojë në çdo hetim dhe të ruaj nivelet e duhura të konfidencialitetit. Dështimi për ta bërë këtë do të konsiderohet një çështje të rëndë disiplinore.

ROLET DHE PËRGJEGJËSITË E PERSONELIT NË PËRGJIGJEN NDAJ POHIMEVE PËR ABUZIM DHE SHFRYTËZIM SEKSUAL

2.18 Personeli dhe menaxherët duhet të jenë të vetëdijshëm për rolet dhe përgjegjësitë e tyre ndaj përgjigjes, hetimit dhe referimit të pohimeve për abuzim dhe shfrytëzim seksual tek autoritetet kombëtare siq përshkruhet në procedurat lokale.

SISTEMET MENAXHESE PËR T'U PËRGJIGJUR, MENAXHUAR DHE MËSUAR NGA INCIDENTET

2.19 Save the Children International dhe Programi i saj Ndërkombëtare, secili program vendor dhe secila Zyrë Rajonale duhet të krijojnë sistem të menaxhimit të aftë për të menaxhuar një incident duke mbështetur dhe ndihmuar viktimat dhe duke nxjerrur mësim si rezultat i ndodhjes, raportimit, hetimit apo menaxhimit të çdo Incidenti në bazë të Politikës së Mbrojtjes së Fëmijëve në mënyrë që të nxirren mësimet dhe të përmirësohen praktikat.

2.20 Mësimet e nxjerra në zbatimin e përgjithshëm të kësaj Politike, si dhe nga incidentet individuale duhet të përdoren për të influencuar politikën dhe për zhvillimin e praktikave më të mira në mbarë lëvizjen e Save the Children dhe gjetiu kur është e përshtatshme.

2.21 I gjithë personeli dhe përfaqësuesit duhet të jenë të vetëdijshëm se çdo shqetësim apo pretendim për abuzim apo shfrytëzim të fëmijëve, i ngritur kundër tyre do të hetohet, në bazë të Politikave të Mbrojtjes së Fëmijëve:

- a. duke shqyrtuar referimin tek autoritetet ligjore për hetimin dhe ndjekjen penale sipas ligjit të vendit në të cilën ata punojnë, kur pretendimi është një shkelje e mundshme e ligjit dhe / ose
- b. nga Save the Children, në përputhje me Procedurat e Përgjithshme për ballafaqim me Abuzimin ose Shfrytëzimin e Dyshuar dhe sipas procedurave disiplinore, të cilat mund të rezultojnë me shkarkim.